



Republika e Kosovës



Komuna- Vushtrri

REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

Nr. / Br 614/09  
Nr. i fq. / Br. st -14-  
Data: / Datum 24.09.2009

VUSHTRRI - VUÇITRN

RR E G U L L O R E  
PËR ORGANIZIMIN E TRANSPORTIT RRUGOR NË TRRRITORIN E KOMUNES  
SË VUSHTRRIË

Shtator 2009



Republika e Kosovës



Komuna- Vushtri

02Nr.614/09  
Më 24.09.2009

Në bazë të neneve 6, 7 dhe 19.2 të Ligjit për transportin rrugor, nr.2004/1, të nenit 3 dhe 10 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugorë 2004/1 nr. 02/L-127 G. Z. e Republikës së Kosovës nr. 35/2008 si dhe Nenit 12. 2 pika C të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L -040 G. Z. Republikës së Kosovës nr 28/2008 si dhe Nenit 31 dhe 71 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 24.09.2009, miratoi këtë:

**R R E G U L L O R E**  
**PËR ORGANIZIMIN E TRANSPORTIT RRUGOR NË TERRITORIN E**  
**KOMUNES SË VUSHTRRISË**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Me këtë Rregullore rregullohet:

- a) Ushtrimi i veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave në territorin e komunës së Vushtrrisë (më poshtë komuna);
- b) lejimi ose ndalimi i përdorimit të autobusëve për transport publikë të udhëtarëve në rrugë të caktuara;
- c) pikat e stacioneve dhe vend ndaljet në linjat për autobusë, marrja dhe zbritja e udhëtarëve dhe çështje tjera lidhur me transportin e udhëtarëve;
- d) rregullimi ose ndalimi i transportit të udhëtarëve që qëndrojnë në këmbë; çështja e pajisjeve dhe mjeteve (të brendshme ose të jashtme) të autobusëve publikë, duke përfshirë rregullimin ose ndalimin e përdorimit të shpalljeve, shenjave dhe reklamave, brenda apo jashtë autobusëve publikë;
- e) Krijimin parakushteve për rregullimin e taksi-transportit të udhëtarëve dhe mallrave;
- f) Krijimin dhe mbështetjen e konkurrencës së drejtë mes operatorëve të transportit dhe njëkohësisht mbështetjen e interesave të udhëtarëve;



## Neni 2

### Përkufizime

Në kuptim të kësaj Rregulloreje termat e mëposhtme kanë këto kuptime.

**“Transport publik”**: transporti që me kushte të njëjta është i përshtatshëm për të gjithë

shfrytëzuesit e shërbimeve të transportit.

**“Licencë”**: nënkupton aktin me të cilin lejohet ushtrimi i veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve ose mallrave.

**“Leje e transportit”**: nënkupton aktin e caktuar me këtë rregullore në bazë të të cilave kryhet transporti rrugor i udhëtarëve ose i mallrave.

**“Operator i transportit”**: personi juridik a fizik, i cili ushtron veprimtarinë e transportit

publik.

**“Drejtues automjeti”**: personi, i cili ka fituar shkallën e nevojshme të kualifikimit për drejtimin e një mjete motorik.

**“Transport i rregullt udhëtarësh”**: shërbim i rregullt transporti në itinerare dhe

vendqëndrime të pandryshuara, të ofruara nga transportuesi dhe të përcaktuara më parë,

shërbim i cili kryhet vetëm me autobus dhe mund të jetë urban, dhe urbano-periferik,

**“Transport urban”**: Transporti i ushtruar brenda kufijve urban të komunës.

**“Transporti urbano periferik”**: transport i ushtruar brenda territorit të komunës.

**“Vozitje shtesë “ (bis-vozit).**

**„Transporti taksi”**: nënkupton transportin jo të rregullt (transportin jashtë linjor)

**„Transporti për nevoja personale”**: nënkupton transportimin e personave ose të mallrave të cilin e kryejnë pa kompensim personat fizik ose juridik, për ti plotësuar nevojat e prodhimit ose të shërbimeve në kuadër të veprimtarive të veta.

**“Transporti i veçantë linjor”**: nënkupton transportin e vetëm një numri të caktuar të udhëtarëve i cili kryhet në bazë të kontratës me shkrim ndërmjet operatorit të transportit dhe porositesit të transportit, me ç’rast transportin e paguan porositesi.

**„Transporti me qira dhe pagesë”**; nënkupton transportin e mallrave me automjetin transportues apo tërësi të mjeteve të transportit të kryer me qëllime komerciale për personat tjerë fizik dhe juridik përfshirë shërbimet speciale të rregullta, që bartin grupe udhëtarësh të organizuar me iniciativë të konsumatorit ose vetë bartësit.

**“Auto Taksi”**: nënkupton veprimtarinë e transportit të udhëtarëve e cila ushtrohet nga personat fizik dhe juridik.

**„Taksi operator”** – është personi juridik i cili ushtron këtë veprimtari (me së pak 5 automjete).

**“Rrugë publike”**: rruga magjistrale, regjionale ose lokale me të drejtë të drejtimit për trafik publik.

**“Stacioni i autobusëve”:** Objekti i licencuar nga Ministria e Transportit dhe Postë

Telekomunikacionit që të ofroj shërbime të rregullta për operatorët transportues dhe udhëtarët.

**“Vendndalim”:** lokacioni i sinjalizuar ku u mundësohet ndalja autobusëve për të zbritur dhe marrë udhëtarët.

**“Fletudhëtim”:** dokumenti i udhëtimit të automjetit që mund të kryej transportin e udhëtarëve në rrugë.

**“Udhëtar”:** nënkupton personin të cilin e transporton operatori i transportit me kompensim dhe i cili në bazë të kontratës ka të drejtë transporti.

**“Linjë”:** përmbledhja e nisjeve nga pikënisja deri në pikërritjen e stacionit të autobusëve, gjegjësisht në vendndalime ku transportohen udhëtar ose mallra sipas rendit të publikuar dhe të regjistruar në një apo më shumë nisje në atë relacion.

**“Linjë e udhëtarëve”:** linja e cila në rendin e udhëtimit përveç pikës së nisjes dhe të mbarimit përmban dy e më shumë vend-ndalje.

**“Relacion”** distanca në mes dy vendeve në linjë të cilat në rendin e udhëtimit janë të regjistruara si stacione të autobusëve.

**“Tarifë”** akti i cili përmban çmimin lidhur me transportin dhe kushtet tjera transportuese.

**“Rend i udhëtimit”:** akti i cili përmban emrin e kompanisë transportuese, korridorin në të cilin kryhet transporti, llojin e linjës, renditjen e stacioneve të autobusëve apo vendbanimeve, si dhe distancën nga pikënisja apo stacioni ku fillon, kohën e nisjes dhe arrijtes nga stacionet e autobusëve gjegjësisht nga vendbanimet, mbikëqyrjen e mbajtjes së linjës në atë korridor si dhe afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.

**„Lëshues i Licencës”:** nënkupton organin i cili sipas dispozitave të kësaj rregulloreje është kompetent për lëshimin e saj.

### Neni 3

Rregullimin dhe organizimin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave, së bashku me procedurën, kriteret dhe rregullat në lidhje me dhënien dhe vërtetimin e rendeve të udhëtimit operatorëve të transportit në territorin e komunës e bënë Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Drejtoria për Shërbime Publike:

a. Përcakton politikat e zhvillimit të shërbimeve të transportit, të sigurta, efikase

dhe ekonomike brenda territorit të Komunës;

b. Nxjerr Planin e transportit lokal dhe e ndryshon atë sipas nevojës;

d. Publikon Planin apo Planin e ndryshuar dhe një kopje të tij ia dërgon Ministrisë së Transportit dhe të Postë-telekomunikacionit (më poshtë Ministria).

Plani duhet të jetë në përputhshmëri me politikën e zhvillimit të tërësishëm të transportit në Kosovë.



#### **Neni 4**

Operatorët e transportit që kryejnë veprimtari transporti në territorin e komunës janë të detyruar:

- a. të përdorin mjete të transportit që janë teknikisht në gjendje të rregullt,
- b. të mbajnë në mënyrë të rregullt regjistrin dhe dokumentet për çdo automjet për veprimtarinë e vet transportuese, të parapara sipas Ligjit për transportin rrugor.
- c. të plotësojnë evidenca statistikore sipas formave të miratuara nga organet përkatëse dhe t'i raportojnë ato sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

#### **Neni 5**

5.1. Operatori i transportit publik të udhëtarëve nuk mund të ushtrojë veprimtarinë para se të pajiset me leje dhe rend të udhëtimit.

5.2. Komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin transportit brenda territorit të saj si vijon:

- transportin e rregullt të udhëtarëve,
- transportin e lirë të udhëtarëve,
- transportin taksi të udhëtarëve dhe
- transportin për nevoja personale,

## **II. TRANSPORTI I RREGULLT RRUGOR I UDHËTARËVE**

#### **Neni 6**

6.1. Transporti rrugor i udhëtarëve në territorin e komunës ushtrohet si transport i rregullt urban dhe urbano-periferik i udhëtarëve me autobusë

6.2. Ndalohet çdo ushtrim i veprimtarisë së transportit të rregullt urban dhe urbano-periferik pa u pajisur me licenc dhe me rend të vërtetuar të udhëtimit.

6.3. Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobusë kryhet në relacione të caktuara (linja) sipas rendit të udhëtimit, të përcaktuar dhe të vërtetuar më parë, çmimit të caktuar e të shpallur dhe kushteve të tjera të transportit.

6.4. Drejtoria për Shërbime Publike planifikon rrjetin e linjave urbane dhe urbane-periferike dhe numrin e orareve ne to.

6.5. Komuna mund të lidhë marrëveshje me komunat tjera për rregullimin reciprok të transportit të udhëtarëve. Marrëveshja është e plotfuqishme nëse miratohet nga Ministria.

#### **Neni 7**

7.1. Veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave kryhet në bazë të licencës dhe lejes së punës.

7.2. Licencën dhe Rendin e Udhëtimit e lëshon Drejtoria për Shërbime Publike, ndërsa lejen e punës Drejtoria për Ekonomi bujqësi dhe zhvillim.

7.3. Licenca vlen më së shumti 5 vjet nëse organi që e ka lëshuar atë nuk vendosë ndryshe, ndërsa leja e punës një vit.

7.4. Licenca është e patjetërsueshme dhe e patransformueshme,

7.5. Licencat jepen kundrejt një pagese të përcaktua në bazë të Rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale

7.5 Licenca nuk është e nevojshme për automjetet e ndihmës së shpejtë, të zjarrfikësve, etj.

## **Marrja e Licencës**

### **Neni 8**

a) Kushtet bazë për dhënien e Licencës për transport urban dhe urbano-periferik, janë:

b) Të ketë në pronësi së paku (2) dy autobusë me afat valid të regjistrimit dhe me gjendje teknike të rregullt të tyre,

c) Të ketë të punësuar së paku 3 punëtor, prej tyre;

- një ngasës profesional me patentë shofer valid të kategorisë përkatëse,
- një mekanik, autoelektracist apo profil tjetër për mirëmbajtje dhe
- një punëtor administrativ.

d) Të ketë biznesin e regjistruar pranë MTI-së,

e) Selia e kompanisë të jetë në territorin e komunës,

f) Në qoftë se inspektori dyshon në parregullsi teknike të autobusëve me të cilët kryhet transporti i udhëtarëve, mund të urdhëroj kontrollin e jashtëzakonshëm teknik të tyre.

## **Humbja e Licencës**

### **Neni 9**

9.1. Licenca humbë vlefshmërinë:

- kur kërkon mbajtësi i saj,
- kur pushon së ekzistuari plotësimi i ndonjë kushti të paraparë me këtë rregullore,
- kur vdes ose humb zotësinë mbajtësi i saj,
- përfundon afati i licencës,
- nëse mbajtësi i saj shkel detyrimet e përcaktuara me Ligjin për Transportin nr. 2004/1 dhe me këtë rregullore,

Procedurën për revokimin apo anulimin e Licencës e fillon inspektori i komunikacionit, ndërsa revokimin e bën organi që ka lëshuar licencën.

### **Neni 10**

10.1. Rendi i udhëtimit është akt me të cilin përcaktohen elementet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt në transportin rrugor, në territorin e komunës, i cili përmban:



- emrin e transportuesit,
- relacionin,
- llojin e transportit,
- radhitjen e vend ndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare,
- kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vend ndalje,
- periudhën kohore në të cilën mbahet linja,
- afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.

10.2. Rendi i udhëtimit vlen një vit.

### **Neni 11**

Transportuesi është i obliguar që transportin t'a kryejë në mënyrë të rregullt dhe sipas rendit të udhëtimit, të vërtetuar dhe të regjistruar.

### **Neni 12**

12.1. Transportuesi obligohet që ta fillojë veprimtarinë e transportit të rregullt urban të udhëtarëve në afat prej 3 ditësh, nga dita e fuqizimit të rendit të udhëtimit, dhe atë nuk mund ta ndërpres përderisa zgjat afati i rendit të udhëtimit.

12.2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, transportuesi mund përkohësisht të ndërpresë veprimtarinë, si rezultat i kushteve të jashtëzakonshme të cilat pamundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt urban.

12.3. Për ndërprerjen, nga paragrafi 2 i këtij neni, transportuesi është i obliguar që të bëjë kërkesë në drejtorinë, i cili do të lëshojë vendim për pranim apo refuzim të kërkesës së transportuesit.

12.4. Transportuesi nuk mund ta ndërpret (pezullojë) veprimtarinë e transportit të rregullt urban në linjë, sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të vërtetuar pa lejen e Drejtorisë.

### **Neni 13**

13.1. Transportuesi rendin e udhëtimit nuk mund ta tjetërsoj, e as ta jep me qira.

13.2. Transferimin e rendit të udhëtimit e benë vetëm Drejtoria për Shërbime Publike.

13.3. Emri i transportuesit, i shënuar në rendin e udhëtimit, duhet të jetë i njëjtë me atë të shënuar në librezën e qarkullimit të autobusit dhe në dokumentet tjera përcjellëse të autobusit.

## **Neni 14**

14.1. Drejtoria do të revokojë rendin e udhëtimit në kushtet kur:

- në afat prej 3 ditësh, nga dita e fuqizimit, nuk e fillon ushtrimin e
- veprimtarisë;
- brenda një muaji kalendarik, pa miratimin e Drejtorisë nuk benë nisjen 3
- herë;
- bënë ndërprerje të kohëpaskohshme të mbajtjes së nisjes, respektivisht kur 12 herë brenda afatit të zgjatjes së rendit të udhëtimit nuk mban nisjen pa miratimin e Drejtorisë.

14.2. Linjat dhe nisjet e revokuara do të konsiderohen si të lira, dhe të njëjtat i nënshtrohen procedurës për ndarjen e tyre.

14.3. Operatori i transportit është i obliguar që ndryshimin e rendit të udhëtimit dhe të drejtimit të transportit, ndaljen e përkohshme apo të përhershme të transportit, paraprakisht të miratuar nga Drejtoria, në linjën e lejuar, ta shpallë përmes shtypit apo një mjeti tjetër të informimit.

14.4 Në qoftë se inspektori dyshon në parregullsi gjatë mbajtjes së rendit të udhëtimit, mund të urdhëroj revokimin rendit të udhëtimit.

## **Neni 15**

15.1. Transportuesi bën përcaktimin e çmimit të biletës. Çmimoren e miraton Drejtoria e Ekonomisë dhe zhvillimit. Çmimorja duhet të vendoset në autobusin që çarkullon në atë linjë.

15.2. Personeli i autobusit merr pagesën për shërbime (biletën) vetëm në bazë të çmimore, nga paragrafi 1 i këtij neni.

## **Neni 16**

Çdo udhëtar në autobus duhet të pajiset me biletë, përveç personave me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuara të cilët posedojnë dokumente valide identifikimi. Bileta mund të blihet në autobus apo vende të tjera, tek të cilat transportuesi ka besuar shitjen e tyre.

## **Transporti i veçantë**

### **Neni 17**

17.1. Transport i veçantë i udhëtarëve është transporti i grupeve të caktuara të udhëtarëve, duke përjashtuar udhëtarët tjerë, në relacion të caktuar dhe në bazë të lejes së veçantë.

Me transport të veçantë të udhëtarëve kryhet transporti i:

- nxënësve dhe studentëve, nga vendbanimi deri të shkolla dhe anasjelltas dhe
- punëtorëve, nga vendbanimi deri në punë dhe anasjelltas.



17.2. Lejet për transport të veçantë lëshohen në bazë të Kontratës, e cila duhet të ketë:

- relacionin,
- listën e udhëtarëve,
- çmimin e transportit, vendet për marrje dhe zbritje të udhëtarëve dhe
- kohën, gjatë së cilës kryhet transporti.

17.3 Kontratën e bënë transportuesi, paraprakisht i licencuar nga Ministria ose Komuna, dhe porositësi i shërbimeve për grupin e udhëtarëve, ku porositësi është njëkohësisht edhe pagues i transportit.

17.4 Lejen për transport, sipas këtij neni, e lëshon Drejtoria për Ekonomi me pëlqimin paraprak të Drejtorisë për Shërbime Publike,.

17.5 Leja, sipas këtij neni, nuk përmban rendin e udhëtimit dhe çmimoren.

17.6 Në autobus, në pjesën e përparme, në vend të dukshëm, duhet të jetë mbishkrimi "Transport i veçantë".

### **Transporti për nevoja personale**

#### **Neni 18**

18. 1. Operatori transportues, personi tjetër juridik ose fizik dhe qytetari i cili ka automjetin transportues, mund të kryejë transport për nevoja vetjake dhe atë transportin e punëtorëve të vet, ose personave tjerë që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarisë së vet, si dhe transportin e anëtarëve të familjeve të punëtorëve kur shkojnë në pushim apo rekreacion.

18.2. Transport i udhëtarëve për nevoja personale, në kuptim të kësaj Rregulloreje, konsiderohet edhe transporti i personave të cilin e bëjnë:

1. ndërmarrjet hoteliere, personat tjerë juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë veprimtari hoteliere,
2. institucionet shëndetësore, si dhe ato të mbrojtjes sociale që bartin të sëmurit,
3. agjencitë turistike, personat tjerë juridikë e fizikë të cilët kryejnë veprimtari turistike ku, në bazë të kontratës së veçantë të transportit, transportojnë grupe turistësh pa pranimin dhe zbritjen e udhëtarëve gjatë rrugës,
4. shoqatat kulturore, sportive dhe shoqatat tjera që transportojnë nxënës, studentë, personel mësimor ose anëtarë të vet,
5. autoshkollat të cilat aftësojnë kandidatët për vozitës gjatë punës së tyre,

6. operatorët transportues ose punëtorët të cilët kryejnë shërbime të veçanta,

#### **Neni 19**

19.1. Në autobusin me të cilin kryhet transporti për nevojat personale, duhet të jetë i plotësuar regjistri i punëtorëve ose i personave tjerë, i vërtetuar nga pronari (transportuesi), ose ndonjë dëshmi tjetër për të drejtën e transportit të këtyre punëtorëve ose personave.

19.2. Në këndin e djathtë, të poshtëm, të xhamit mbrojtës të autobusit me të cilin kryhet transporti i udhëtarëve për nevoja personale, vendoset mbishkrimi "Transport për nevoja personale".

### **III. TRANSPORTI RRUGOR I MALLRAVE**

#### **Neni 20**

20.1. Operatori i transporti rrugor të mallrave në territorin e Komunës së Vushtrrisë (më poshtë i quajtur: transporti i mallrave) kryhet si:

- a/ transporti i mallrave për nevoja personale, me peshën bartëse prej 3.5-12 tona dhe
- b/ transporti i mallrave me qira dhe pagesë.

20.2. Gjatë transportit të mallrave, operatori në automjet duhet t'i ketë këto dokumente:

- licencën dhe
- fletëngarkesën.

#### **Neni 21**

Ndërmarrjet publike komunale të themeluara nga Komuna dhe të formuara me qëllim të kryerjes së shërbimeve publike komunale, nuk do të licencohen.

#### **Transporti i mallrave për nevoja personale**

#### **Neni 22**

22.1. Ndalohet marrja me transport për nevoja personale, pa qenë i regjistruar si transportues për këtë veprimtari.

22.2. Dispozita e paragrafit paraprak nuk do të zbatohet mbi mbajtësin e licencës për transport të mallrave me qira.



## **Neni 23**

23.1 Operatorët e transportit të mallrave për nevoja personale në territorin e Komunës së Vushtrrisë, të cilin kapaciteti i automjetit nuk e kalon peshën prej 12 tonave duhet të pajisen me licencë nga Drejtoria për Shërbime Publike.

23.2. Emri dhe natyra e biznesit duhet të deklarohen kur të regjistrohet veprimtaria e transportit të mallrave për nevoja personale.

23.3. Regjistrimi nuk do të jetë i efektshëm derisa aplikuesi të tregojë së transporti i mallrave për të cilin është kërkuar regjistrimi, mund të emërohet si transport i mallrave për nevoja personale.

## **Neni 24**

Me rastin e kryerjes së transportit për nevoja personale me automjet prej 3,5 deri në 12 tonelata, në automjet duhet të ketë:

- a. fletëngarkesën dhe
- b. dëshminë nga e cila mund të vërtetohet se është fjala për transportin e mallrave për nevoja personale.

## **Transporti i mallrave me qira dhe pagesë**

### **Neni 25**

25.1. Transporti i mallrave me qira dhe pagesë kryhet në bazë të Kontratës së lidhur në mes të qiradhënësit të automjetit transportues dhe qiramarrësit i cili kontraktin transportin e mallrave.

25.2. Gjatë transportit të mallrave me qira dhe pagesë operatori i transportit në automjet duhet të ketë:

- a. fletëngarkesën dhe
- b. kontratën në mes të qiramarrësit dhe qiradhënësit.

## **Transporti jo i rregullt (Transporti Taksi)**

### **Neni 26**

26.1 Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë taksi pa u pajisur me Lejen e duhur për ushtrimin e veprimtarisë taksi.

26.2 Poseduesi i Lejes si taksi individual nuk mund të autorizojë dikë tjetër për ushtrimin e veprimtarisë taksi.

## **Neni 27**

- 27.1. Operatori taksi duhet të ketë: Licencën dhe Lejen ndërsa taksi individual duhet të ketë vetëm Lejen për ushtrimin e veprimtarisë taksi.
- 27.2. Licenca vlen më së shumti 5 vjet, nëse organi që e ka lëshuar atë nuk vendosë ndryshe, ndërsa Leja për automjete vlen më së shumti 1 vjet.
- 27.3. Licenca mund të vazhdohet në bazë të kërkesës së mbajtësit të saj nëse paraqet kërkesë me shkrim më së paku 15 ditë para skadimit të afatit, ndërsa Leja mund të vazhdohet po ashtu në bazë të kërkesës me shkrim, nëse ajo bëhet më së largu deri në fund të vitit të vlefshmërisë.
- 27.4. Në qoftë se vazhdimi i Licencës/Lejes nuk bëhet sipas afatit të paraparë nga pika 3, Licenca/Leja humb, automatikisht anulohet.
- 27.5. Për çdo vazhdim të licencës/Lejes, kërkesës duhet ti bashkëngjitet, përpos tjerash edhe dëshmia për kryerjen e obligimeve për taksat komunale.
- 27.6. Licenca/Leja nuk do të vazhdohet nëse nuk plotësohet kushti i paraparë në pikën 5 të këtij neni.

## **Neni 28**

### **Kushtet për marrjen e Licencës dhe Lejes “Operatori taksi”**

Për marrjen e Licencës Operatori “taksi” do ti plotësoi këto kushte:

- 28.1. Të ketë certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- 28.2. Të ketë më së paku 5 automjete dhe më së shumti 15 automjete në pronësi, të cilat duhet të jenë të modelit të njëjtë dhe me ngjyrë të njëjtë;
- 28.3. Të ketë më së paku 5 vozitës cilët të plotësojnë kushtet ligjore për taksi – transport;
- 28.4. Të ketë vend parking, frekuenca, zyrë, lidhje telefonike dhe servis in për mirëmbajtje (apo kontrata për mirëmbajtje);
- 28.5. Selia e ndërmarjes të jetë në territorin e komunës së Vushtrrisë.
- 28.6. Operatorëve taksi u ndalohet kryerja e veprimtarisë taksi me shoferët-drejtuesit të cilët nuk kanë së paku dy vjet përvojë në patentë shoferin.

### **“Taksi individual”**

## **Neni 29**

Për marrjen e Lejes për ushtrimin e veprimtarisë taksi automjeti duhet ti plotësohen këto kushte;

- 29.1. Automjeti ti ketë 4 (katër) dyer;
- 29.2. Të ketë më së shumti 4+1 ulëse dhe vend për bagazh;
- 29.3. Të ketë taksimetrin e programuar sipas tarifave të përcaktuara;
- 29.4. Të jetë teknikisht në rregull.
- 29.5. DEBZH mund të përcaktojë kushte më të përafërta shtesë.



### **Neni 30**

Për marrjen e Lejes taksi personi duhet t'i plotëson këto kushte:

- 30.1. Të jetë banorë i komunës së Vushtrisë
- 30.2. Të ketë patentë shoferin së paku 2 vjet të vjetër dhe të ketë vlefshmëri;
- 30.3 Të ketë certifikatën mjekësore për ushtrimin veprimtarisë taksi;
- 30.4. Të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë taksi
- 30.5. DEBZH mund të përcaktojë kushte më të përafërta shtesë.
- 30.6. Kushtet e parapara të transportit taksi të nenit 29 dhe 30 vlejné edhe për transportuesit taksi me automjetin 8+1 ulëse dhe pa taksimetër, të cilët mund të ushtrojnë fushëveprimin e vet të këtij lloji taksi me Pëlqimin e DSHP-së në ato pjesë të komunës ku nuk ka operatorë të interesuar të transportit me autobus.

### **Neni 31**

Licenca /Leja humb nëse:

- a) Kërkon mbajtësi i saj;
- b) Përfundon afati i saj;
- c) Vdes ose humb aftësinë mbajtësi i saj;
- d) Nëse pushojné së ekzistuari kushtet në bazë të të cilave është dhënë;
- e) nëse mbajtësi i saj shkel detyrat e përcaktuara me këtë Rregullore apo me ligjin për transportin rrugor nr. 2004/1.

### **Neni 32**

- 32.1 Automjetet me të cilat zhvillohet veprimtaria taksi do të kontrollohen çdo vit nga ana e Inspektionit, nëse vazhdojnë të jenë në gjendje të rregullt për të kryer veprimtarinë taksi.
- 32.2. Nëse inspektori dyshon në gjendjen e tyre teknike, mund të urdhërojë kryerjen e kontrollit të jashtëzakonshëm teknik të automjeteve me të cilat zhvillohet kjo veprimtari.
- 32.3 Automjetet mund të zëvendësohen kurdo që ka nevojë poseduesi i tyre me njoftimin paraprak të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim.
- 32.4. Çdo zëvendësim evidentohet në librin e lejeve të lëshuara nga drejtoria.

### **Procedurat për marrjen e Lejes për taksi**

#### **Neni 33**

- 33.1. Për marrjen e Lejes për ushtrimin e veprimtarisë taksi, pala e interesuar duhet të bëjë kërkesë me shkrim.
- 33.2. Sipas nevojës së paraqitur DEZH mund ta kufizoi numrin e taksive.
- 33.3. Parashtruesit e kërkesës në radhë, duhet të njoftohen për vendin e lirë për taksi.
- 33.4 Pas njoftimit, parashtruesi i kërkesës është i obliguar që në afatin prej 15 ditësh të paraqitet tek organi kompetent për plotësimin e kushteve ligjore.

33.5. Në qoftë se brenda këtij afati nuk paraqitet parashtruesi i kërkesës, do të njoftohet parashtruesi i kërkesës tjetër sipas radhës.

33.6. Për të plotësuar kushtet e tjera ligjore, DEZH i jep parashtruesit të kërkesës një afat prej 15 ditësh. Nëse këtij afati nuk përmbushen kushtet ligjore, humb e drejta për t'u pajisur me Licencë/Leje.

#### **Neni 34**

34.1 Vendqëndrimet apo vend parkimet për taksi, mënyrën e shfrytëzimit të tyre, e cakton në mënyrë të veçantë Drejtoria e Urbanizmit dhe DSHP-së.

34.2 Ushtruesit e veprimtarisë së transportit jo të rregullt-taksi, janë të obliguar t'i përmbahen mënyrës së vendqëndrimeve për taksi sipas pikës një të këtij neni.

### **Dispozitat Ndëshkimore**

#### **Neni 35**

Operatori i transportit, përkatësisht personi tjetër juridik ose fizik, do të ndëshkohet për kundërvajtje me gjobë prej 300 deri në 3500 € nëse:

1. Ushtron veprimtarinë e transportit të rregullt të udhëtarëve pa pasur Licencën ose Rendin e vërtetuar të udhëtimit (Neni 6 pika 2).
2. Ushtron veprimtarinë e transportit jo të rregullt apo transportit taksi të udhëtarëve pa Licencë apo pa Leje (Neni 26 pika 1 dhe 2).
3. Nuk i kryen urdhrat e inspektorit për eliminimin e parregullsive në afat të caktuar (Neni 33 Pika 1 dhe 2).

#### **Neni 36**

Operatori transportues, përkatësisht personi tjetër juridik ose fizik, do të ndëshkohet për kundërvajtje me gjobë prej 200 deri 2000 €, në qoftë se:

1. Transporti nuk kryhet në mënyrë të rregullt sipas rendit të vërtetuar të udhëtimit (neni 10, pika 1).
2. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 12 pika 1 dhe 4.
3. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 13 pika 1
4. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 14 pika 3 dhe 4.
5. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 16
6. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 19 pika 1 dhe 2.
7. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 22 pika 1.
8. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 23 pika 1.
9. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 25 pika 1.
10. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 28 pika 6.
11. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 34 pika 2.

#### **Neni 37**

Operatori i transportit përkatësisht personi juridik apo fizik do të ndëshkohet për kundërvajtje me gjobë prej 100 € deri në 350 € do të gjobitet nëse:



- a) nuk mban linjën në pajtim me rendin e vërtetuar të udhëtimit neni 6 pika 3 të kësaj rregulloreje.
- b) nëse nuk përcakton çmimoren dhe nuk vendose në vend të dukshëm në automjet të udhëtimit sipas nenin 6 pika 3 dhe 4.
- c) Për kundërvajtje të njëjtë që transportuesi përkatësisht personi juridik apo fizik i përsërit përveç dënimit me gjobë do ti shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë së transportit në kohëzgjatje prej 3 deri në 6 muaj.

### **Dispozitat kalimtare dhe të fundit**

#### **Neni 38**

Për të gjitha çështjet tjera që nuk janë të parapara me këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e ligjit mbi transportin rrugor dhe udhëzimet përkatëse të ligjit.

#### **Neni 39**

Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdesen Organet kompetente Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit, Drejtoria e Inspeksionit, Policia e Kosovës.

#### **Neni 40**

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Vendimi mbi transportin në trafikun urban dhe ndër urban i datës 31.12.2001 dhe rregullorja për organizimin e Transportit Taksi të udhëtarëve e miratuar më 16.07.2004.



Kryesuesi i Kuvendit

*Ferit Idrizi*  
**Ferit Idrizi**